



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1020/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbare të kreditorit Auto Mita Sh.p.k., me NUI:..., me seli në Prishtinë, Magj. Prishtinë-Shkup, fshati Peroc, kundër debitorit N.T.Sh. Shkodra- B. Sh. B.I., me NUI:..., me seli në Çagllavicë, p.n Prishtinë , duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.006/21 të datës 12.01.2021, të Përmbaresit Rezarata Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 13.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.T.Sh. Shkodra- B. Sh. B.I., me NUI:810466286, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbare P.nr.006/21 të datës 12.01.2021 i Përmbaresit Privat Rezarta Metaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbare P.nr.006/21 të datës 12.01.2023 i Përmbaresit Privat Rezarta Metaj.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Auto Mita Sh.p.k., me NUI:..., ka caktuar urdhrin përmbare P.nr.006/21 të datës 12.01.2023, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me nr.20-SHV01-IM4-114 e datës 03.03.2020, faturës me numër 20-SHV01-IM4-115 e datës 03.03.2020, faturës me numër 20-SHV01-IM4-116 e datës 03.03.2020, faturës me numër 20-SHV01-IM4-117 dhe faturës me numër 20-SHV01-IM4-118 e datës 03.03.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit shumën prej 172,500.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e kalimit të afatit të pagesës sipas faturave si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe

të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përmbarruesi privat zbaton përmbarrimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, duke theksuar se përmbarruesi ka gabuar me këtë rast apo ka rënë në lajthim nga kreditori sepse unë si debitor me kreditorin jam në një lloj marrëveshje për pagesën e borxhit të mbetur prej 72,500.00 euro, edhe pas këtij borxhi kam vazhduar të blej vetura nga kreditori. Ka shtuar se në urdhërin e lëshuar përmbarruesi ka gabuar respektivisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 71 pika 1.9 të LPP-së. Andaj i ka propozuar gjykatës ta provoj prapësimin si të bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarrimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se në prapësim debitori nuk e konteston borxhin e kërkuar nga kreditori sipas dokumentit të besueshëm –faturave dhe se pretendimet e debitorit në prapësim nuk e gjejnë asnjë mbështetje ligjore dhe si të tilla prapësimin e bëjnë në tërësi si të pa bazuar, kjo për faktin se nuk është fare e vërtet se me debitorin kemi marrëveshje për pagesën e borxhit, dhe se kur i kemi kërkuar debitorit që të shlyej borxhin e pa paguar, ky i fundit është ankuar se për shkak të pandemisë ka vështirësi në pagesë të borxhit dhe ka kërkuar nga ne që t'ia mundësojmë shlyerjen e borxhit me ndonjë këst. E për kundër këtij fakti i njëjti ka vijuar me blerjen e 2 veturave të tjera nga ne të cilin fakt e konfirmon vet përmes prapësimit. Ka shtuar se është evidente se prapësimi i debitorit është i pa bazuar ngase nuk mbështetet në asnjë provë sikurse parashihet në nenin 69 par.6 të LPP-së dhe se mungojnë shkaqet e prapësimit të parapara në nenin 71 të po të njëjtit ligj. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta refuzoj si të pa themeltë prapësimin e debitorit, urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbnim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbnimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – faturës me nr.20-SHV01-IM4-114 e datës 03.03.2020, faturës me numër 20-SHV01-IM4-115 e datës 03.03.2020, faturës me numër 20-SHV01-IM4-116 e datës 03.03.2020, faturës me numër 20-SHV01-IM4-117 dhe faturës me numër 20-SHV01-IM4-118 e datës 03.03.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbnimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbnimore, vlerëson se urdhri për përmbnim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi

bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1020/22, datë 13.11.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.